



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-052

Prishtinë, më 4 dhjetor 2018, në orën 17:15

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 4 DHJETOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerand Stavileci.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi dhe Musli Krasniqi.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit në lidhje me rrethanat që kishin çuar në mosmbajtjen e seancës së jashtëzakonshme. Ai shtoi se pak më herët e përcaktuam një seancë të jashtëzakonshme në bazë të kërkesës së dy grupeve parlamentare, përkatësisht dy grupeve parlamentare dhe 42 nënshkrimeve. Gjatë mbledhjes së Kryesisë, dy kryetarët e grupeve parlamentare i shtruan disa shqetësime në lidhje me nënshkrimet e deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme. Mirëpo, edhe pse unë kërkoja sqarime nga parashtruesi i kërkesës, nuk pati asnjë reagim nga ta.

Ndërkohë kemi marrë një shkresë, e cila është protokolluar, në të cilën theksohet se deputetët e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila dhe Ilir Deda, nuk kanë dhënë nënshkrime për këtë seancë të jashtëzakonshme dhe kanë deklaruar se ka ndodhur manipulim me emrat e tyre, se ata s'e kanë dhënë nënshkrimin fare.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me rrethanat e krijuara.

Në lidhje me rregullsinë e kërkesës për seancë të jashtëzakonshme diskutuan: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së dhe Mufera Srbica-Sinik, në emër të GP "6+", diskutimet e të cilëve janë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari kërkoi deklarinimin e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit për mosmbajtjen e seancës së jashtëzakonshme. Shumica e anëtarëve të Kryesisë e mbështetën propozimin e kryetarit.

Në fund, kryetari konstatoi se nuk mund të vazhdojë seanca e jashtëzakonshme, e cila është kërkuar për faktin se është lënduar procesi nga vetë iniciuesi i kërkesës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 17:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale